

**UDHËZIM**  
**Nr. 18, datë 8.5. 2020**

**PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT, VLERËSIMIN E NXËNËSVE, PROVIMET PËRFUNDIMTARE DHE MBYLLJEN E VITIT SHKOLLOR 2019–2020, NË SHKOLLAT PROFESIONALE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE, NË KUSHTET E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA E COVID-19**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, shkronja “b”, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 18/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” dhe të pikës 6.1 të vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”,

**UDHËZOJ:**

1. Në lidhje me vijimin e mësimi *online* dhe rikthimin e maturantëve në shkollë:
  - a) Për nxënësit e klasës 10 (të gjitha strukturat arsimore), të klasës 12 (struktura arsimore 2+2) dhe të klasave 11 dhe 12 (struktura arsimore bllok 4-vjeçare), mësimi në kushtet e shtëpisë do të vijojë deri në datën 29.5.2020, duke synuar një pjesëmarrje sa më të madhe dhe sa më aktive të nxënësve.
  - b) Për nxënësit e klasave 11 dhe 12 (struktura arsimore 2+1+1) dhe të klasës 11 (struktura arsimore 2+2), të cilët kanë provime të nivelit, mësimi në kushtet e shtëpisë do të vijojë deri në datën 29.5.2020, duke synuar një pjesëmarrje sa më të madhe dhe sa më aktive të nxënësve.
  - c) Për nxënësit maturantë, në klasën 13, mësimi në kushtet e shtëpisë do të vijojë deri në datën 15.5.2020, duke synuar një pjesëmarrje sa më të madhe dhe sa më aktive të nxënësve.
  - d) Për nxënësit maturantë, mësuesit e lëndëve të kulturës së përgjithshme, që nuk janë pjesë e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale, do ta mbyllin realizimin e programit mësimor në datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.
  - e) Për nxënësit maturantë, mësuesit e lëndëve të teorisë profesionale që nuk janë përfshirë në Provimin e Teorisë Profesionale të Integruar (sipas programit orientues përkatës), do ta mbyllin realizimin e programit në datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.
  - f) Për nxënësit maturantë, në periudhën 18.5.2020–5.6.2020, do të vijojë mësimi në shkollë sipas urdhrin nr. 103, datë 27.4.2020 të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.
  - g) Për nxënësit maturantë, përqendrimi i mësimi në kushtet e shtëpisë dhe gjatë kthimit në shkollë do të jetë parapërgatitja për katër provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale. Gjatë kësaj periudhe do të zhvillohet vetëm përsëritje bazuar në Programet Orientuese të rishikuara përkatëse, të publikuara nga (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK).
  - h) Shkollat profesionale përgatisin orarin e ri për realizimin e mësimi për nxënësit maturantë gjatë periudhës së rikthimit në shkollë.
  - i) Për nxënësit maturantë, vijueshmëria e mësimi në shkollë do të realizohet sipas pikave 6 dhe 7/“a”, “c”, “p”, “g”, të urdhrin të ASCAP-së, nr. 45, datë 29.4.2020, “Për organizimin e mësimi, vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019–2020, për klasën 12”, të zbatuara për klasën 13 në shkollat profesionale.
  - j) Për nxënësit e klasave, të cilët do të kryejnë Provimin e Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit *online*, përqendrimi i mësimi në kushtet e shtëpisë, do të jetë parapërgatitja dhe përsëritja në lëndët që përfshihen në këto provime, bazuar në programet orientuese përkatëse të publikuara

nga AKAFPK-ja, duke marrë në konsideratë lëndët dhe temat e realizuara deri më 9 mars 2020, sipas evidencave në regjistrave përkatës në shkollë.

## 2. Në lidhje me provimet përfundimtare

a) Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale (gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj e parë dhe teori profesionale e integruar) do të zhvillohen në periudhën 8.6.2020–18.6.2020.

b) Modalitetet e realizimit të provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të MASR-së dhe MFE-së nr. 27, datë 26.11.2019, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2020”, me rregulloren “Për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2020 në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin e ministrit nr. 537, datë 8.11.2019, si dhe udhëzimet në vijim të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (MASR) dhe të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) për këtë qëllim.

c) Provimet e Praktikës Profesionale të Integruar të Nivelit nuk do të zhvillohen.

d) Provimet e Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit, për nxënësit e klasave 11 dhe 12 (struktura 2+1+1) dhe të klasës 11 (struktura 2+2), do të zhvillohen *online* në periudhën 8.6.2020–12.6.2020.

e) Për Provimet e Teorisë Profesionale të Nivelit *online*, grafiku i provimeve, përgatitja e testeve teorike, skema e vlerësimit të testit, realizimi i provimit *online*, korrigjimi dhe nxjerrja e rezultateve (notave) do të kryhen nga komisionet e vlerësimit përkatëse të çdo shkolle profesionale, sipas udhëzimit nr. 15, datë 26.4.2019, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve përfundimtare në arsimin dhe formimin profesional”.

f) Testi i Teorisë Profesionale të Nivelit *online* do të përmbajë 25 njësi testi me zgjedhje (alternativa) dhe koha që do t’u jepet nxënësve për plotësimin *online* do të jetë 60 minuta.

g) Përmbajtja e testit *online* do të bazohet në Programin Orientues përkatës të publikuar nga AKAFPK-ja. Në këtë test nuk do të përfshihen pyetje që i referohen programit mësimor të realizuar *online* pas datës 9.3.2020 (sipas evidencave të regjistrave përkatës).

h) Mënyra e realizimit të testit *online* (programet, aplikacionet, mjetet) përcaktohen nga komisionet e vlerësimit përkatëse të shkollave, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve, ruajtjen e fshehtësisë dhe shmangien e fiktivitetit në provim.

i) Për nxënësit që do ta kenë të pamundur të marrin pjesë në provimin e Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit *online*, në përshtatje me rrethanat dhe kushtet që do të krijohen në vijim, do të jepen udhëzime të mëvonshme për të mundësuar edhe realizimin e këtij provimi.

## 3. Në lidhje me vlerësimin e nxënësve

a) Për nxënësit maturantë, vlerësimi i vazhduar dhe përcaktimi i notës vjetore për lëndët e kulturës së përgjithshme do të bëhen sipas pikës 8 të urdhrin të ASCAP-së, nr. 45, datë 29.4.2020, “Për organizimin e mësimit, vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019–2020, për klasën 12”, të zbatuar për klasën 13 në shkollat profesionale.

b) Për nxënësit e klasave 10, 11 dhe 12, vlerësimi i vazhduar dhe përcaktimi i notës vjetore për lëndët e kulturës së përgjithshme do të bëhen sipas udhëzimeve të MASR-së.

c) Për të gjithë nxënësit që marrin pjesë në mësimin *online*, bëhet vlerësimi i vazhduar me nota për lëndët profesionale dhe modulet (projektet mësimore) profesionale, duke konsideruar angazhimin dhe rezultatet e arritura.

d) Nota përfundimtare vjetore, për lëndët profesionale dhe modulet (projektet mësimore) profesionale, do të llogaritet duke konsideruar notat e marra nga nxënësi gjatë mësimit në shkollë dhe gjatë mësimit *online*.

e) Për nxënësit që e kanë pasur të pamundur të marrin pjesë në mësimin *online*, nota përfundimtare vjetore për lëndët profesionale dhe modulet (projektet mësimore) profesionale do të llogaritet duke konsideruar vetëm notat e marra gjatë mësimit në shkollë, para datës 9.3.2020.

f) Nota e Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar të Nivelit, për çdo nxënësi (përfshirë dhe nxënësit maturantë), do të llogaritet si mesatare e thjeshtë, e rrumbullakosur në numër të plotë, e notave të moduleve praktike (projekteve mësimore) që nxënësi ka përmbushur në nivelin përkatës.

g) Për nxënësit që e kanë pasur të pamundur të marrin pjesë në mësimin *online*, nota e provimit të Praktikës Profesionale të Integruar të Nivelit do të llogaritet duke konsideruar vetëm notat e marra gjatë mëimit praktik para datës 9.3.2020, për përbushjen e nivelit përkatës.

h) Nota përfundimtare e Provimit të Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit, për çdo nxënësi, do të llogaritet duke marrë në konsideratë jo vetëm rezultatet e Provimit të Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit *online*, por edhe mesataren e notave të të gjitha lëndëve teorike profesionale të zhvilluara në nivelin përkatës.

i) Formula për llogaritjen notës përfundimtare të Provimit të Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit është si më poshtë:

$$N = 0,7 K1 + 0,3 K2, \text{ ku}$$

- N është nota përfundimtare (e rrumbullakosur në numër të plotë) e Provimit të Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit;

- K1 është mesatarja e thjeshtë e notave e të gjitha lëndëve teorike profesionale, që nxënësi ka përbushur në nivelin përkatës;

- K2 është nota që nxënësi ka marrë në Provimin e Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit, *online*.

j) Për nxënësit që do ta kenë të pamundur të marrin pjesë në provimin e Teorisë Profesionale të Integruar të Nivelit *online*, por do ta japin këtë provim në një periudhë të mëvonshme, sipas pikës 2/i, nxjerrja e notës përfundimtare përkatëse bëhet sipas pikës 3/i të këtij udhëzimi.

4. Në lidhje me mbylljen e vitit shkollor 2019–2020:

a) Të gjitha shkollat profesionale duhet të marrin masat e nevojshme sipas pikës 1/“a”, “b”, “c”, të urdhrit nr. 103, datë 27.4.2020, të MASR-së.

b) Të gjitha shkollat profesionale duhet të marrin masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit shkollor nga të gjithë mësimdhënësit.

c) Drejtuesit e shkollave profesionale duhet të raportojnë mbi vijimin e mëimit lidhur me rezultatet dhe problematikat e evidentuara, si dhe mbylljen e vitit shkollor 2019–2020, pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe shkollat profesionale publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË  
**Anila Denaj**